

**RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR FALIMENTIMIN”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, si dhe të lehtësojë zgjidhjen dhe shlyerjen e detyrimeve të debitorit brenda dhe/ose jashtë procedurës së falimentimit.

Ligji ekzistues mbi falimentimin është vlerësuar si tepër kompleks dhe i vështirë për t'u zbatuar. Kjo gjeneron përshtypjen se sistemi aktual ligjor mbi procedurat e falimentimit përbën një mjet të pamjaftueshëm për shpëtimin e biznesit. Për pasojë, sistemi aktual nuk është përdorur gjerësisht, dhe në ato raste kur është përdorur, ka patur pak mundësi për të shpëtuar vlerën. Disa nga arsyet kryesore për këtë situatë janë si më poshtë:

- Ligji është tepër i gjatë, i vështirë për t'u interpretuar dhe relativisht i huaj për skistemin ligjor shqiptar. Ligji aktual ndjek versionin fillestar të ligjit gjerman të vitit 1994, me pak ose aspak përshtatje me rrethanat e vendit tonë.
- Ligji përfshin një sistem të menaxhimit të biznesit në vështirësi, që nuk ofron një mënyrë të përshtatshme për të nxitur përdorimin nga ana e debitorëve.
- Ligji nuk parashikon një rregullim të plotë dhe të përshtatshëm të efektit të hapjes së procedurës së falimentimit dhe në përgjithësi, nuk ka dispozita që mbrojnë vazhdimësinë e biznesit gjatë procedurës së falimentimit dhe shitjes së mundshme të biznesit si një vijimësi;
- Sistemi nuk parashikon ashpërsimin e masave ndaj debitorëve që refuzojnë të japin informacion ose që japin informata të rreme ndaj pjesëmarrësve në procesin e falimentimit;
- Ka disa elemente shumë të rëndësishme të një sistemi modern falimentimi që nuk pasqyrohen në ligjin aktual.
- Ka një rregullim minimal për administratorët e falimentimit dhe për Agjencinë, e cila ka funksione të paqarta.
- Ka mungesë parashikimesh për insolvencën ndërkufitare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Problemi i kredive me probleme është konsideruar si një problem shqetësues për Shqipërinë. Edhe pse vendi ynë nuk vuajti menjëherë pasojat e krizës globale financiare dhe krizës në Euro, niveli i kredive me probleme u rrit në mënyrë të qëndrueshme. Një pjesë e madhe e kredive me probleme është e kolateralizuar me pasuri të patundshme dhe është e koncentruar kryesisht në sektorin e ndërtimit. Ky problem është evidentuar edhe nga FMN dhe Banka Botërore si një nga problemet më kryesore me të cilën përballlet vendi ynë.

Për këtë arsye, me kërkesë të autoriteteve shqiptare, një mision i asistencës teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) u paraqit në Tiranë gjatë muajit Prill 27- 4 Maj 2015 për të ndihmuar autoritetet shqiptare në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për adresimin e situatës së kredive me probleme (NPL) në sistemin financiar shqiptar. Në raportin përfundimtar të dërguar nga FMN, është konkluduar se trajtimi i problemit të NPL-ve është i rëndësishëm për ringritjen e nivelit të kreditit në Shqipëri.

Në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për këtë problem u sugjerua ngritja e një grupi pune ndërinstitucional të nivelit të lartë i cili që kishte si synim adresimin dhe reduktimin e nivelit të kredive të këqija në sistemin bankar.

Grupi i punës u përqendrua në faktin se, në përgjithësi, kur nivelet e NPL-ve janë vazhdimisht të larta në një ekonomi të caktuar, ato tregojnë ekzistencën e një sërë problemesh më të thella në sistemin juridik. Në raportin e dorëzuar nga FMN theksohen fusha të caktuara në kuadrin ligjor, ku një përpjekje për të përmirësuar më tej këtë kuadër ligjor mund të prodhojë rezultate më të mira në uljen e nivelit të NPL-ve.

Reforma të mëtejshme në të gjitha fushat juridike konsiderohen ato në sistemin e taksave, ristrukturimin e borxhit, të zbatimit të borxhit, dhe mos aftësinë paguese. Reformat ligjore duhet të zbatohen në koordinim me veprimtarinë mbikëqyrëse dhe rregullatore në mënyrë që ato të kenë një zbatim sa më të saktë dhe në kohë.

Pas ngritjes së këtij Grupi Pune, është miratuar dhe nënshkruar nga Kryeministri dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Plani i Masave për reduktimin e Kredive të Këqija në Sistemin Bankar.

Në këtë plan Masash, Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për hartimin e një ligji të ri për falimentimin.

Kërkesa për propozimin e këtyre ndryshimeve vjen si kërkesë e Grupit ndërinstitucional të punës, të koordinuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ngritur me Urdhër Kryeministri nr.78 datë 11.06.2015, për çështjen e kredive me probleme në Shqipëri. Ky grup pune ka hartuar planin e masave i cili ka për synim reduktimin e nivelit të kredive me probleme në sistemin bankar, duke evidentuar masat konkrete me propozime për ndryshime konkrete, si dhe duke përcaktuar institucionin përgjegjës për secilën masë. Ky plan masash është bashkëfirmosur nga Kryeministri dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave, ose, nëpërmjet riorganizimit ose arritjes së një marrëveshjeje tjetër të re, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së debitorit. Një ligj me procedura të qarta ndihmon në arritjen e këtij qëllimi.

Procedura, në kuptim të këtij ligji, mund të realizohet nëpërmjet:

- a) Likuidimit,
- b) Riorganizimit,

c) Ristrukturimit të borxhit për konsumatorët me të ardhura të rregullta, ose

d) Ristrukturimit të borxhit për subjektet tregtare përmes marrëveshjeve jashtëgjyqësore, të miratuara nga gjykata e falimentimit.

Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.

Projektligji sanksionon parime të rëndësishme që duhet të respektohen gjatë procedurës.

Grupi i punës në përgatitjen e draftligjit mbi procedurat e falimentimit mori në konsideratë:

- Studimin mbi dhe analizën e gjendjes ekzistuese dhe gjetjet përkatëse nga grupi i ekspertëve lokalë;
- Opinionet e aktorëve dhe institucioneve të përfshira në procedurat e falimentimit, lidhur me shkaqet dhe vështirësitë e zbatimit të ligjit ekzistues;
- Studimin e praktikës gjyqësore dhe analizimin e rasteve kur është vendosur hapja e procedurave të falimentimit, pezullimi i tyre, pushimi i tyre apo përfundimi i tyre;
- Studimin e tregut dhe të vështirësive financiare nga këndvështrimi i bizneseve, i bankave ekzekutimit të detyrueshëm përmes prbarimit, etj;
- Analizën krahasuese të ligjeve aktuale për falimentimin, veçanërisht: Ligjin Amerikan me Kapitullin 11, nga i cili u mor në konsideratë si model nënkapitulli me definicionet dhe konceptet; Ligjin Italian nga i cili u mor si model nënkapitulli për ristrukturimin e borxhit përmes një marrëveshje jashtëgjyqësore; Ligjin Gjerman të falimentimit nga i cili u morën në konsideratë ndryshimet e bëra pas vitit 2012, meqenëse legjislacioni ekzistues është bazuar në legjislacionin gjerman; Ligji e vendeve të rajonit si Serbia dhe Mali i Zi.
- Opinionet komentet dhe sugjerimet e ekspertëve ndërkombëtarë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar mbështetet në nenet 78, 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për Falimentimin” synon të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, si dhe të lehtësojë zgjidhjen dhe shlyerjen e detyrimeve të debitorit brenda dhe/ose jashtë procedurës së falimentimit. Ai përmban 210 nene dhe përbëhet nga 11 pjesë.

Në pjesë e parë trajtohen parimet e procedurës së falimentimit.

Në pjesën e dytë trajtohet hapja e procedurës së falimentimit, palët pjesëmarrëse dhe masa e falimentimit.

Në pjesën e tretë trajtohen pasojat e hapjes së procedurës së falimentimit, përmbushja e veprimeve juridike dhe kundërshtimet e veprimeve të dëmshme në procedurën e falimentimit.

Në pjesën e katërt trajtohet administrimi dhe posedimi i masës së falimentimit, përcaktimi i pretendimeve dhe vendimi për riorganizim ose likuidim.

Në pjesën e pestë trajtohet riorganizimi dhe rehabilitimi i përshpejtuar, e veçanërisht procedura për miratimin e planit të riorganizimit, efektet dhe mbikëqyrja e tij.

Në pjesën e gjashtë përcaktohet procedura e likuidimit dhe shpërndarjes.

Në pjesën e shtatë rregullohen dispozitat për shkakrimin nga detyrimet e pashlyera.

Në pjesën e tetë trajtohet procedura e falimentimit në lidhje me shtetet e huaja.

Në pjesën e nëntë rregullohet statusi dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

Në pjesën e dhjetë renditen shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative.

Pjesa e njëmbëdhjetë rendit dispozitat kalimtare.

Drafti i ri i ligjit të falimentimit ka një nënkapitull që lidhet me përkufizimet, meqenëse kjo u kërkua nga përfaqësuesit e institucioneve dhe të palëve të përfshira në procedurat e falimentimit. Kështu janë parashikuar rreth 40 përkufizime si: kreditor, kreditor i masës së falimentit, kreditor i rangjeve më të ulta, administrator i falimentimit, administrator monitorues, familje bujqësore, etj.

Risite kryesore të projektligjit mund të përmbliidhen si më poshtë:

➤ **Risite lidhur me subjektet që i nënshtrohen falimentimit**

- Projektligji parashikon zgjerimin e diametrit të rrethit të subjekteve, tek të cilët shtrihet efektet e veta falimentimi ku përfshihen: personat fizikë (të tillë si individë, konsumatorë apo tregëtarë); personat juridikë (të tillë si, personat juridik privatë dhe publikë, fitimprurës dhe jofitimprurës); si dhe njësitë administrative vendore.

- Lidhur me rrethin e veprimtarive me interes të publikut, projektligji ka parashikuar që këto subjekte do t'i nënshtrohen rregullave të përgjithshme të falimentimit, kur falimentimi rregullohet nga ligjet e posaçme, duke mbetur në këtë pikë në parashikimiet që ka edhe ligji ekzistues. Ndërkohë projektligji ka parashikuar që ky rregullim të ndikojë mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari në interes publik vetëm për sa kohë ato janë të licencuar për kryerjen e këtyre veprimtarive.

- Po ashtu, është vendosur si një risi nga Projektligji, se në rast se ligjet e posaçme që rregullojnë sektorët publik apo strategjik, nuk parashikojnë rregullat e falimentimit, atëherë çdo subjekt, sipas paragrafit të parë të këtij neni, ka të drejtë të kërkojë hapjen e procedurës së falimentimit, vetëm pasi të marrë lejen paraprake nga autoriteti rregullator përkatës.

- Po ashtu, projektligji parashikon se si anëtarët e komitetit të kreditorëve mund të emërohen edhe persona që nuk janë kreditorë, por përfaqësues të një autoriteti rregullator në rastet kur debitori ushtron veprimtari në sektorin e interesit publik të tillë që kontrollohet prej tij.

- Lidhur me kompetencat e gjykatës, janë qartësuar kompetencat dhe procedurat e vendimmarrjes së gjykatës, duke e bërë më fleksibël dhe të shpejtë ndërhyrjen e gjykatës nëpërmjet vendimeve apo urdhërave që jepen vetëm me bazë konsultimi mbi aktet, pa nevojën e një seance dëgjimore të detyrueshme.

➤ **Risitë që lidhen me subjektet monitoruese**

- Në projektligj sugjerohet që rrethi i subjekteve monitoruese apo që kanë të drejtën që të jenë të mirë-informuara lidhur me procedurat e falimentimit të mbetet jo vetëm në kuadrin e AMF-së, të gjykatës së falimentimit, të mbikqyrësit, apo të kujdestarit, (sic është në ligjin ekzistues), por të shtohet edhe roli i Prokurorisë, i Kontrollit të Lartë të Shtetit apo i Autoriteteve Mbikqyrëse të sektorëve të ndryshëm me interes publik. Roli i këtyre subjekteve lidhet me marrjen dijeni apo verifikimin e dokumentave, vendimeve gjyqësore, të planit të riorganizimit, ristrukturimit të borxheve apo të transfertave të tre viteve të fundit të subjektit para falimentimit. Kjo me qëllim shmangien e abuzimit apo mashtrimit me procedurat e falimentimit. Projektligji parashikon se "... me marrjen e një kopjeje të vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit, prokurori, me qëllim shmangien e abuzimit ose mashtrimit me procedurat e falimentimit, verifikon transfertat dhe veprimet juridike që lidhen me asetet/pasuritë e debitorit dhe të personave të lidhur me të, të kryera, të paktën tri vitet e fundit përpara hapjes së procedurës së falimentimit".

- Një çështje e rëndësishme për diskutim është ajo që lidhet me rolin dhe statusin e AMF-së, kufijtë e kompetencave dhe modeli që do të ndiqet. Roli dhe pozita e AMF-së duhet të shihet e lidhur ngushtë me mundësinë e zgjerimit të spektrit të subjekteve kontrollues dhe mbikqyrës, të aktorëve të rinj pjesëmarrës, që do të bëjnë kujdes për të kontrolluar jo thjesht procedurën e falimentit, por në mënyrë të vecantë do të mbikqyrin rastet që lidhen me abuzimin dhe mashtrimin në faliment. Një kompetencë e re që parashikon projektligji për AMF-në është se "... Agjencia kërkon të paktën një raportim në çdo 3 muaj nga ana e administratorit të falimentimit, një kopje e të cilit ia dërgon edhe gjykatës së falimentimit".

➤ **Risitë që lidhen me kostot dhe shpenzimet e falimentimit**

- Ligji aktual, parashikon mbylljen ose mos-fillimin e procedurës së falimentimit dhe çregjistrimin nga regjistri kombëtar të debitorit, i cili nuk ka mjetet e mjaftueshme për të mbuluar kostot e procedurës së falimentimit. Ky rregullim krijon mundësi të mëdha për skema mashtrimi nëpërmjet falimentimit. Grupi i punës ka kërkuar të gjejë zgjidhje që të shmangi dështimin e procedurës së falimentimit, për shkak të mungesës së mjeteve të debitorit.

- Lidhur me çështjet e kostove apo të shpenzimeve të falimentimit të cilat figurojnë si një nga pengesat që bllokojnë procedurën kur subjekti ka paaftësi paguese, projektligji parashikon krijimin një *depozite garancie* për të mbulua këto shpenzime. Kjo depozitë parashikohet të krijohet si një fond i posaçëm nga subjektet tregtare apo sipërmarrësit pas vitit të tretë të veprimtarisë së tyre dhe depozitohet në bankë në emër të tyre, me kusht që depozituesi rifiton të drejtën e përdorimit të saj në rastin kur e mbyll veprimtarinë e vet me anë të likuidimit. Përrjashtimisht, depozita e paaftësisë paguese mund të përdoret me urdhër të gjykatës së falimentimit, në fazën e likuidimit të procedurës së falimentimit. Projektligji ka edhe dispozita

tranzitore për subjektet që janë të treg pa u rrezikuar nga falimentimi ose për subjekte që janë në prag të këtij procesi apo në procedurat e falimentimit.

- Veç kësaj, projektligji parashikon një mundësi që të parashikohet një fond publik që do të menaxhohet nga AMF-ja dhe që synon të shmangë bllokimin e procedurave për shkak të dorëheqjes së administratorit apo të refuzimit të detyrës prej tij. Parashikimi i riskut të falimentimit që në zanafillën e një aktiviteti tregtar nuk e step atë, por e bën më realist. Meqënëse, nga pikëpamja ekonomike, një biznesi i duhet të paktën tre vjet të kutpojë nëse po operon me sukses apo jo, projektligji i jep mundësi subjekteve tregtare që të shohin se nëse kurba e fitimit të tyre vjen drejt shifrave pozitive pas tre vitesh, ata në këtë moment të krijojnë depozitën e sipërpërmendur. Në të kundërt, ata mund të kalojnë në likuidim kur konstatojnë se nuk janë ë sukseshëm, pa e çuar gjendjen e tyre financiare drejt falimentimit.

➤ **Risite që lidhen me rolin dhe statusin e administratorit**

- Lidhur me administratorin, projektligji ka parashikuar si risi qartësimin e personave që marrin role mbikqyrëse gjatë procedurës së falimentimit. Në projektligj parashikohen tre lloj administratorësh: administratori i falimentit, administratori i përkohshëm i falimentimit dhe administratori mbikqyrës, të cilët kanë të njëjtin status dhe të njëjtat kriteret përzgjedhëse, por që marrin rolet sipas momentit kohor kur veprojnë apo specifikave të rolit që përmbushin.

- Lidhur me trajtimin e administratorit, draftigji ka parashikuar si risi ndarjen e shpërblimit të administratorit në dy pjesë: administratori i falimentimit ka të drejtën e pagës mujore, si dhe të drejtën e shpërblimit si përqindje mbi sasinë e detyrimeve të shlyera nga masa e falimentimit dhe të rimbursimit për shpenzimet e bëra gjatë përmbushjes së detyrës. Masa e shpërblimit llogaritet në kohën e përfundimit të procedurës së falimentimit. Niveli i pagës mujore vlerësohet në varësi të vëllimit dhe të shkallës së vështirësisë gjatë ushtrimit të detyrës së administratorit të falimentimit. Rregullat e hollësishme lidhur me pagën, kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit, do të përcaktohen me Vendim nga Këshilli i Ministrave. Çdo administrator falimentimi ka detyrim të realizojë të paktën një procedurë falas në çdo tre vjet. Kjo ndarje është bërë për të motivuar administratorët në përmbushjen e detyrës së tyre në maksimizimin e masës së falimentimit.

- Po ashtu, projektligji parashikon një garanci të re për kryerjen e detyrës së administratorit, duke sanksionuar se administratori i falimentimit, para pajisjes me licencë, depoziton në formën e garancisë një shumë monetare. Shuma e depozitës caktohet nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit.

- Krahas administratorit të falimentimit draftligji parashikon edhe rolin e kujdestarit, të kujdestarit të trashëgimisë apo të ekzekutorit të falimentit të cilët janë subjekte që njihen e trajtohen edhe jashtë procedurës së falimentimit, nga Kodi Civil.

➤ **Risite lidhur me bashkërendimi e ligjit për procedurat e falimentimit me ligjin për procedurat tatimore.**

- Projektligji parashikon se nga pikëpamja procedurale ligji i falimentimit do të preferohet si i vetmi ligj që rregullon këtë procedurë në raport me ligjin mbi tatimet dhe taksat.

Ky rregullim duhet të shoqërohet me rishikim të legjislacionit mbi tatimet dhe taksat. Në këtë drejtim, projektligji parashikon shfuqizimin e nenit 104 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

➤ **Lidhur me ristrukturimin e borxhit përmes një marrëveshjeje jashtëgjyqësore që do të miratohet nga gjykata** projektligji sjell një grup dispozitash që parashikojnë krahas riorganizimit edhe ristrukturimin e borxhit, si pjesë e një zgjidhjeje jashtëgjyqësore përmes alternativave të zgjidhjes së konflikteve, duke arritur në një marrëveshje që duhet të miratohet nga gjykata.

➤ **Lidhur me radhën e preferimit**

➤ Për herë të parë në historinë e legjislacionit për falimentimin që është miratuar pas viteve '90, në draftin e ri ka disa dispozita që parashikojnë një radhë të posaçme preferimi për shlyerjen e detyrimeve para dhe pas rishpërndarjes.

➤ Një ndryshim rrënjësor në projektligjin e ri të falimentimit, është ai që parashikon se rradha e preferimit e parashikuar në nenin 605 të Kodit Civil, nuk është e përshtatshme për t'u përdorur në kontekstin modern të falimentimit.

➤ Për këtë arsye, projektligji ka parashikuar detyrimin që përpara se të fillojë shlyerja e pretendimeve të kreditorëve sipas radhës së preferimit, të veçohen fillimisht shpenzimet e procedurës së falimentimit.

➤ Pas kësaj, projektligji ka shtuar një nen të ri me një rradhë preferimi, ku parashikohet radha e shpërndarjes së pasurisë duke u nisur fillimisht nga pretendimet e siguruara deri në vlerën e pronës që shërben si garanci. Pas kësaj, rradhiten pretendimet prioritare, ku përfshihen:

-pretendimet që rrjedhin nga ndërprerja e kontratës së punësimit deri në 3 muaj përpara paraqitjes së kërkesës për falimentim, duke përfshirë pagat dhe rimbursimet shëndetësore, pagesat e lejes së lindjes, të cilat nuk kalojnë shumën 500 mijë Lek në total;

-pretendimet për mbështetje dhe mirëmbajtje që lindin përpara fillimit të procedurës së falimentimit, kur debitori është një individ;

-pretendimet e punonjësve të debitorit për dëme shëndeti të shkaktuara gjatë punës;

-pretendimet për veprime të padrejta që rrjedhin si pasojë e dëmit të shkaktuar ndaj jetës ose shëndetit nga debitori përpara fillimit të procedurës së falimentimit;

-pretendimet për taksat e papaguara një vit përpara paraqitjes së kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.

➤ **Risite lidhur me penalitetet**

• Lidhur me penalitetet, projektligji ka parashikuar në mënyrë përfundimtare se në rastin e abuzimeve me procedurën e falimentimit, do të ketë përgjegjësi administrative, ndërsa ato penale të parashikohen vetëm në Kodin Penal.

➤ **Risite që lidhen me falimentimin ndërkufitar**

• Lidhur me falimentimin ndërkufitar, projektligji ka parashikuar përfshirjen në një kapitull më vete me objektivin strategjik që adoptimi i Ligjit Model të UNCITRAL-it mbi Procedimet e Paaftësisë Paguese Ndërkufitare të dërgonte sinjal të fortë besueshmërie tek investitorët e huaj në kërkim të niveleve më të larta të parashikueshmërisë në sistemin shqiptar të falimentimit.

VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Përgatitja e këtij projektakti, është bërë nga ekspertët e IFC, bazuar në marrëveshjen e konsulencës së nënshkruar me Ministrinë e Drejtësisë. Projektligji në fazën e parë është konsultuar me një listë të gjerë aktorësh si:

- ministrinë e linjës;
- gjyqtarë;
- FMN;
- Shoqatën Shqiptare të Bankave;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Këshillin e Investimeve;
- Administratorë të Falimentit;
- Shoqata e Ekspertëve Kontabël;
- Agjencia e Mbikqyrjes Financiare;
- Euralius;
- Agjencia e Mbikqyrjes së Falimentit.

Në vijim të komenteve dhe tryezave të zhvilluara nga ana e IFC, drafti është ripunuar dhe do të përcillet sërish për mendim.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare negative për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

YLLI MANJANI